



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 196

17 dhjetor

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr. 171/2013 datë 26.11.2013	Për miratimin e Buxhetit faktik të Shtetit për vitin 2012 8049
Rezolutë e Kuvendit datë 27.11.2013	8050
Udhëzim i MSH dhe i MF nr. 585/1, datë 5.12.2013	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 2, datë 15.1.2013 “Mbi procedurat e prodhimit, kodimit, stampimit, shpërndarjes dhe monitorimit të pullave të kontrollit të barnave”, të ndryshuar. 8051
Vendim i GJK nr. 52, datë 2.12.2013	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshme me Kushtetutën dhe Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, të vendimeve: nr. 8843, datë 10.12.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 837, datë 23.6.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2012-1527, datë 26.6.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi)..... 8052
Vendim i GJK nr. 53, datë 9.12.2013	Me objekt: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr. 00-2011-2343 (542), datë 24.11.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 1534, datë 21.3.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 00-2011-2343 (542), datë 24.11.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë..... 8061
	Vendim për shpalljen të zhdukur të shtetasit Eduart Belegu.... 8068

LIGJ
Nr. 171/2013

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK TË SHTETIT PËR VITIN 2012

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 158 të Kushtetutës, si dhe të nenit 63 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Miratimi i buxhetit faktik

Miratohet Buxheti faktik i Shtetit për vitin 2012, së bashku me burimet e tij të financimit, si më poshtë:

	Në milionë lekë
1. Buxheti i Shtetit	
Të ardhurat, gjithsej	274 260
Shpenzimet, gjithsej	306 298
2. Buxheti i sigurimeve shoqërore	
Të ardhurat	89 221
Shpenzimet	89 860
3. Buxheti i sigurimeve shëndetësore	
Të ardhurat	15 648
Shpenzimet	28 828
4. Deficiti buxhetor	- 45 857
5. Financimi i deficitit buxhetor	45 857
I brendshëm	26 495
A. Me instrumente financiare (kredimarrje e brendshme, neto)	24 783
1. Kredimarrje nga pushteti qendror	24 714
Bono thesari	8 913
Obligacione qeveritare 2/3/5/7-vjeçare	15 801
2. Kredimarrje nga pushteti vendor	69
B. Të ardhura nga privatizimi	1 221
C. Të tjera	491
Ndryshimi i gjendjes së arkës	- 2 390
Të tjera	2 880
Financimi i jashtëm (neto)	19 362.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 26.11.2013

Shpallur me dekretin nr. 8427, datë 16.12.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani



REZOLUTË

- Në respekt të mbështetjes së shumicës dërrmuese të shqiptarëve për anëtarësim të plotë dhe të merituar të Shqipërisë në Bashkimin Europian;

- Me mirënjohje për mbështetjen që Bashkimi Europian i ka dhënë Shqipërisë gjatë gjithë këtyre viteve, në funksion të konsolidimit të shtetit të së drejtës, parimeve të demokracisë dhe ndërtimit të një ekonomie tregu funksionale;

- Duke marrë në konsideratë progresin e bërë nga Shqipëria në procesin e integrimit në Bashkimin Europian, reflektuar në zbatimin e qëndrueshëm të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;

- Duke marrë në konsideratë vlerësimin mbi progresin e arritur nga Shqipëria, në përmbushje të 12-të prioriteteve të përcaktuara në Opinionin e Komisionit Europian;

- Duke marrë në konsideratë faktin se zhvillimi i zgjedhjeve të 23 Qershorit 2013, i vlerësuar në raportin e OSBE/ODIHR-it dhe në Raportin e Progresit 2013 të Komisionit Europian, përbën një sukses të qenësishëm për Shqipërinë;

- Duke mbështetur dhe vlerësuar si një nxitje për vijimin e reformave, propozimin pa kushte të Komisionit Europian për dhënien e statusit të vendit kandidat për Shqipërinë;

- Duke marrë në konsideratë faktin që dialogu politik i realizuar nëpërmjet, gjithëpërfshirjes dhe transparencës, është kusht kryesor për progresin e Shqipërisë në procesin e integrimit europian;

- Duke riafirmuar që integrimi në Bashkimin Europian, është agjenda kombëtare dhe qëllimi strategjik i Shqipërisë, si një vend që synon konsolidimin e demokracisë, respektimin e shtetit të së drejtës, garantimin e pavarësisë së institucioneve të pavarura, forcimin e një ekonomie tregu funksionale, garantimin dhe respektimin e të drejtave themelore të njeriut dhe minoriteteve, që përbëjnë edhe vlerat kryesore mbi të cilat është themeluar Bashkimi Europian;

- Duke qenë të vetëdijshëm për rolin e Kuvendit, si shprehje e vullnetit të popullit, në procesin e integrimit europian, përfshirë rolin kontrollues të Kuvendit, të domosdoshëm në procesin e integrimit europian, nën frymën e bashkëpunimit konstruktiv midis mazhorancës dhe opozitës parlamentare;

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

1. Rikonfirmon se integrimi i Shqipërisë në BE është objektivi madhor i vendit dhe përbën agjendën tonë kombëtare.

2. Vlerëson rekomandimin e Komisionit Europian për dhënien e statusit të vendit kandidat për Republikën e Shqipërisë.

3. Konfirmon qasjen e tij, që përparimi në procesin e integrimit europian të Shqipërisë, bazohet në meritë, në përputhje me reformat dhe arritjet konkrete.

4. Vlerëson mbështetjen që Bashkimi Europian ka dhënë për Shqipërinë gjatë gjithë këtyre viteve, në funksion të konsolidimit të shtetit të së drejtës dhe parimeve të demokracisë funksionale.

5. Thekson se marrja e statusit të vendit kandidat brenda dhjetorit të këtij viti, duhet të përbëjë prioritetin kryesor të punës së Kuvendit të Shqipërisë dhe të Qeverisë.

6. Mbështet Dialogun e Nivelit të Lartë BE-Shqipëri me një pjesëmarrje gjithëpërfshirëse me fokus përmbushjen e 5 prioriteteve kyçe të identifikuar nga Raporti i Progresit për hapjen e bisedimeve për anëtarësim.

7. I kërkon Qeverisë të konsolidojë reformat e arritura që qëndrojnë në themel të propozimit të Komisionit Europian për marrjen e statusit të vendit kandidat dhe t'i avancojë ato, si dhe të thellojë më tej përpjekjet për integrimin në familjen europiane, duke prezantuar një agjendë të qartë/plan veprimi kryesisht me fokus përmbushjen e 5 prioriteteve të Komisionit Europian, të riformuluara në Progres Raportin e fundit, si dhe përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit në një proces gjithëpërfshirës dhe të përshpejtojë procesin e çeljes së bisedimeve për anëtarësim me Bashkimin Europian.

8. I kërkon Qeverisë të angazhohet për marrjen e të gjitha masave për forcimin e shtetit të së drejtës dhe parimeve të demokracisë funksionale, veçanërisht për:

- a) mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- b) ekzekutimin e vendimeve të gjykatave;
- c) mbrojtjen e garancive kushtetuese të nëpunësve të administratës publike;
- ç) konsolidimin dhe mbrojtjen e autonomisë lokale;
- d) luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit;
- dh) mbrojtjen e lirisë ekonomike dhe stabilitetit të ekonomisë së vendit; si dhe
- e) garantimin e një bashkëpunimi konstruktiv midis mazhorancës dhe opozitës parlamentare.

9. Angazhohet të garantojë dhe të fuqizojë integritetin dhe pavarësinë e institucioneve kushtetuese dhe të pavarura, si: Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë, Policia e Shtetit, Kontrolli i Lartë i Shtetit, INSTAT-i, Autoriteti i Mediave Audiovizive etj. dhe i kërkon Qeverisë të bëjë të njëjtën gjë.

10. Angazhohet të shqyrtojë me prioritet dhe në një proces të gjerë konsultimi, kuadrin ligjor që synon përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Europian, si dhe të gjitha nismat të cilat janë pjesë e agjendës reformuese të integritetit të Shqipërisë, në përputhje me Kushtetutën dhe *acquis* e Bashkimit Europian.

11. Thekson rëndësinë e përfshirjes së shoqërisë civile në procesin integrues të vendit, duke u bërë pjesë integrale, kryesisht në përmbushjen e 5 prioriteteve të caktuara nga Komisioni Europian në Progres Raportin 2013.

12. Unanimisht u kërkon vendeve anëtare të Bashkimit Europian që të mbështesin propozimin e Komisionit Europian për dhënien e statusit kandidat për Shqipërinë, si dhe të ardhmen europiane të vendit tonë.

Miruar në datën 27.11.2013

UDHËZIM

Nr. 585/1, datë 5.12.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 2, DATË 15.1.2013 “MBI PROCEDURAT E PRODHIMIT, KODIMIT, STAMPIMIT, SHPËRNDARJES DHE MONITORIMIT TË PULLAVE TË KONTROLLIT TË BARNAVE”, I NDRYSHUAR

Në zbatim të ligjit nr. 10 381, datë 24.2.2011 “Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave si autoritet kontraktues dhe shoqërive “Scipa Security Solutions S.A.” e “Scipa Security Solutions Albania sh.p.k.”, për projektimin, financimin, dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave”, si dhe ligjit nr. 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, neni 20, pika 9, ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Financave

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 2, datë 15.1.2013 “Mbi procedurat e prodhimit, kodimit, stampimit, shpërndarjes dhe monitorimit të pullave të kontrollit të barnave”, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 16.1 ndryshohet si më poshtë:

16.1 Për të gjitha subjektet farmaceutike zbatimi i udhëzimit do të fillojë nga data 1 prill 2014. Pas datës 1 prill 2014, nuk do të lejohen të importohen barna, si dhe nuk do të lejohen të



hidhen në treg brana të prodhuara në vend pa pullën e vetme të kontrollit të barnave të prodhuar nga koncesionari.

2. Pika 16.2 ndryshohet si më poshtë:

16.2 Pas datës 1 prill 2014, me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, inspektimet nga autoriteti përkatës në lidhje me zbatimin e këtij udhëzimi, do të kryhen në të gjithë territorin e vendit. Për shkeljen e dispozitave të këtij udhëzimi do të zbatohen sanksionet e përcaktuara në ligjin nr. 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I SHËNDETËSISË
Ilir Beqaj

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

VENDIM
Nr. 52, datë 2.12.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 24.9.2013 mori në shqyrtim, në seancë plenare mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 29 Akti, që i përket:

KËRKUES: Bujar Dede, përfaqësuar nga avokate Elira Kokona, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Mbrojtjes, Komanda e Repartit Ushtarak nr. 2001.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si të papajtueshme me Kushtetutën dhe Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, të vendimeve: nr. 8843, datë 10.12.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 837, datë 23.6.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2012-1527, datë 26.6.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 41, 42, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatoren e çështjes, Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të mbrojtësit të kërkuarit, që kërkoi pranimin e kërkesës, dhe prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Ministria e Mbrojtjes dhe Komanda e Forcës Detare, që kërkuan rrëzimin e kërkesës dhe, pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi është mobilizuar në ushtri, në datën 20.2.2000, në Forcat Ushtarake Detare, Reparti Ushtarak nr. 2020, Durrës (sot Komanda e Repartit Ushtarak nr. 2001). Në datën 23.11.2000, kërkuesi është aksidentuar rëndë gjatë pastrimit të teknikës ushtarake. Si rrjedhojë e këtij aksidenti, ai është invalid i përhershëm i grupit të parë.

2. Për shkak të pamundësisë së kurimit në vend, nga organet kompetente (Forcat e Armatosura) janë marrë masat për dërgimin dhe shtrimin e tij në një spital në Firenze, Itali, ku qëndron në kurim të vazhdueshëm. Sipas kërkuesit, gjatë kohës së qëndrimit në Itali, në periudhën dhjetor 2000 deri 2.1.2007, ai ka qenë i paralizuar dhe ka kryer 13 ndërhyrje kirurgjikale, fakte që pasqyrohen në raportet dhe kartelën mjekësore.

3. Në vitin 2007, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës për ngritjen e padisë për shpërblimin e dëmit të shëndetit, kërkesë e cila u rrëzua nga gjykata me vendimin nr. 52 Akti, datë 14.2.2007, me arsyetimin se kërkuesi ka mundësi të tjera ligjore për kërkimin e së drejtës së tij.

4. Në datën 5.3.2007, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kërkesëpadi me objekt "*Shpërblimin e dëmit shëndetësor nga aksidenti i datës 22.11.2000, për shumën 9 650 000 lekë*" me palë të paditur Ministrinë e Mbrojtjes dhe Komandën e Repartit Ushtarak 2001, Durrës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 8843, datë 10.12.2007, vendosi rrëzimin e kërkesëpadisë me arsyetimin se është paraqitur jashtë afatit të parashikuar në ligj dhe, si e tillë, duhet rrëzuar si e parashkruar.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 837, datë 23.6.2009, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm, me të njëjtin arsyetim, por duke evidentuar edhe faktin se çështja përbën gjë të gjykuar, pasi kërkuesi i është drejtuar gjykatës edhe më parë me kërkesë për rivendosje në afat për ngritjen e padisë për shpërblimin e dëmit të shëndetit, kërkesë e cila është rrëzuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 52 Akti, datë 14.2.2007.

6. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2012-1527, datë 26.6.2012, ka vendosur mospranimin e rekursit, në dhomë këshillimi.

II

7. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) në datën 24.4.2013, me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve të marra gjatë procesit gjyqësor civil të zhvilluar në gjykatat e zakonshme, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në aspektet e mëposhtme:

7.1 Është kufizuar e drejta e aksesit në gjykatë, në aspektin kohor dhe atë financiar:

7.1.1 *Në lidhje me kufizimet e natyrës kohore:* i) Interpretimi nga gjykatat i nenit 152 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), duke konsideruar llogaritjen e afateve kohore të parashkrimit të veprimit civil të kërkimit të dëmshpërblimit nga ndodhja e aksidentit dhe jo nga ndërgjegjësimi i kërkuesit, i ka mohuar atij të drejtën për të gëzuar një dëmshpërblim të drejtë për dëmet e pariparueshme të shëndetit. ii) Kufizimi kohor i parashikuar nga ligjvënësi për ushtrimin e së drejtës për dëmshpërblim, në kuptim të neneve 608, 625, 640, 641, 643 e vijues të Kodit Civil, duhet vlerësuar në raport me nenet 115, 117 dhe 120 të KC-së, që parashikojnë më shumë se një mundësi për përlllogaritjen e kohës së kufizimit të së drejtës themelore. iii) Afati i parashkrimit 3-vjeçar, i parashikuar nga KPC-ja, në rastin konkret, llogaritet nga momenti që kërkuesi kishte mundësi të ndërgjegjësohej për dëmin shëndetësor e moral të shkaktuar nga aksidenti i vitit 2000. Gjatë shqyrtimit të çështjes, gjykatat nuk kanë marrë në konsideratë as raportet mjekësore që konfirmojnë gjendjen shëndetësore dhe pamundësinë e tij për të kryer veprime juridike.



7.1.2 Në lidhje me kufizimet e natyrës financiare: Detyrimi për pagimin e taksës gjyqësore në shumën 1% të vlerës së pretenduar si dëmshpërblim kufizon të drejtën e aksesit në gjykatë, si rezultat i mosfunksionimit efektivisht, në praktikë, të shërbimit të ndihmës ligjore.

7.2 Gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë:

7.2.1 Është *cenuar e drejta për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë* si rezultat i mospranimit të rekursit në dhomë këshillimi, ndonëse përbante shkaqe për kalimin dhe shqyrtimin në seancë plenare;

7.2.2 Po ashtu, nuk është respektuar *standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor* nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pasi mungojnë arsyet e mospranimit të rekursit.

8. **Subjekti i interesuar, Ministria e Mbrojtjes**, ka paraqitur me shkrim, në mënyrë të përmbledhur, këto prapësime:

8.1 Pretendimet e kërkuarit nuk argumentojnë cenimin e ndonjë të drejte kushtetuese gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në gjykatat e zakonshme.

8.2 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të drejtë e ka rrëzuar padinë për rivendosjen në afat, pasi ky rregull nuk gjen zbatim mbi afatet e parashikuara nga ligji material.

8.3 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e së drejtës për akses në gjykatë për shkak të barrierave kohore, për faktin se kjo e drejtë nuk është absolute, por u nënshtrohet kufizimeve të parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës, në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe të parimit të sigurisë juridike. Në këtë kuptim, afatet e parashkrimit përbëjnë rastin më tipik të këtij kufizimi.

8.4 Për sa u përket fakteve dhe provave të parashtruara nga kërkuari, për vërtetimin e “forcës madhore”, prapësohen pasi ato nuk hyjnë në rrethin e çështjeve që vlerëson juridiksioni kushtetues, por i përkasin juridiksionit të gjykatave të zakonshme.

8.5 Kërkuari nuk legjitimohet as për pretendimin e cenimit të së drejtës për akses në gjykatë për shkak të barrierave financiare, pasi ky kërkim është i natyrës abstrakte dhe nuk është ngritur në kontekstin e një çështjeje konkrete.

8.6 I pabazuar është edhe pretendimi për mosarsyetimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, për faktin se parashkrimi i padisë, sipas ligjit, ngrihet në çdo fazë të procedimit, prandaj analiza kushtetuese e këtij pretendimi është e padobishme dhe Gjykata nuk duhet të investohet.

9. **Subjekti i interesuar, Komanda e Forcës Detare**, ka paraqitur me shkrim, në mënyrë të përmbledhur, këto prapësime:

9.1 Pretendimet e parashtruara nga kërkuari, në lidhje me afatin e paraqitjes së kërkesëpadisë, për shkak të gjendjes shëndetësore, dhe konsiderimi i këtij shkak si një forcë madhore, nuk i përkasin rrethit të çështjeve që përfshihen në juridiksionin kushtetues.

9.2 Kërkuarit nuk i është *cenuar e drejta e aksesit në gjykatë*, pasi legjislacioni parashikon një sërë mjetesh procedurale si përfaqësimi apo institucioni i kujdestarisë, të cilat, në rast se do të ishin marrë në konsideratë nga kërkuari apo përfaqësuesit e tij, do të çonin në zgjidhjen në themel të çështjes lidhur me pretendimin për dëmshpërblimin nga dëmi i pësuar.

9.3 E drejta e aksesit në gjykatë, duke mos pasur natyrë absolute, i nënshtrohet një sërë kufizimesh, ku rasti më tipik janë afatet parashkruese të padive, të parashikuara nga ligji material ose procedural. Këto afate kanë për qëllim vendosjen e disa standardeve kohore për realizimin e një të drejte, kalimi i të cilave bën që personi të cilit i përket kjo e drejtë të konsiderohet se ka hequr dorë prej tyre. Ato synojnë, gjithashtu, realizimin e së drejtës brenda një afati të arsyeshëm, në të kundërt, në tejkallim të këtyre afateve, e drejta e humbet kuptimin dhe qëllimin e saj.

9.4 Në vështrim të kuadrit kushtetues dhe ligjor, të jurisprudencës kushtetuese vendase dhe asaj të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), rezulton se edhe pretendimi në lidhje me cenimin e së drejtës për akses, për shkak të kufizimeve të natyrës financiare, është i pabazuar. Për më tepër, mosparapagimi, nga ana e tij, e taksës së padisë, në 1% të vlerës së saj, nuk ka qenë shkak për rrëzimin e kërkesëpadisë nga gjykatat e zakonshme.

III Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

10. Gjykata, paraprakisht, thekson se, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Ky raport midis juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006; nr. 58, datë 24.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

A. Në lidhje me pretendimin për cenimin e aksesit në gjykatë

11. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e së drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor. Aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera (*shih vendimet nr. 14, datë 26.3.2012; nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 7 datë 11.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. E drejta për t'iu drejtuar një gjykate nuk është absolute. Kjo e drejtë mund të jetë pjesë e kufizimeve (veçanërisht lidhur me kushtet e pranimit të një apelimi), por këto kufizime duhet të ndjekin një qëllim legjitim dhe mjetet e përdorura duhet të jenë përpjesëtimore me qëllimin që kërkohet të arrihet (*shih vendimet nr. 30, datë 17.6.2010; nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 41, datë 28.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Asnjëherë nuk përjashtohet mundësia që interesat e administrimit të drejtë të drejtësisë mund të justifikojnë një kufizim financiar në të drejtën e aksesit në gjykatë. Megjithatë, duke pasur parasysh vendin e rëndësishëm që zë e drejta e aksesit në një shoqëri demokratike, këto kufizime nuk duhet të kufizojnë aksesin në një mënyrë apo shkallë që dëmton thelbin e kësaj të drejte. Mundësia financiare e aplikantit për të paguar tarifën dhe faza e procesit gjyqësor në të cilin është vendosur ky kufizim, merren në konsideratë si faktorë materialë për të përcaktuar nëse aplikanti e ka gëzuar të drejtën e aksesit (*shih vendimin nr. 7, datë 27.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. GJEDNJ-ja është shprehur se interpretimi i ngushtë i së drejtës së aksesit, që garantohet nga neni 6 § 1 i KEDNJ-së, nuk është në përputhje me objektin dhe qëllimin e këtij parashikimi. Rëndësia e ushtrimit të të drejtave procedurale ndryshon në varësi të qëllimit të veprimeve, të cilat personi në fjalë synon të ushtrojë para gjykatave (*shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Nataliya Mikhaylenko kundër Ukrainës, nr. 49069/11, 30 maj 2013, §37*). Për sa i përket zbatimit të afateve kohore të paraqitjes së ankimeve, GJEDNJ-ja është shprehur se këto afate nuk duhet të zbatohen në mënyrë të tillë që i pengon palët nga përdorimi i mjeteve në dispozicion dhe, po ashtu, pengon shqyrtimin në themel të pretendimeve, në shkellje të së drejtës për mbrojtje efektive nga gjykatat (*shih vendimet e GJEDNJ-së në çështjet Miragall Escolano dhe të tjerë kundër Spanjës, §§ 33 dhe 37, 2000-I; Zvolský e Zvolská kundër Republikës së Çekisë, §§ 51, 53- 54, 2002-IX*).



14. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se gjykatat e zakonshme kanë refuzuar të shqyrtojnë në themel pretendimet e kërkuarit në lidhje me shpërblimin e dëmit shëndetësor, me arsyetimin se e drejta e paraqitjes së padisë është parashkruar. Gjykata e Rrethit Gjyqësor arsyeton se *“në referim të neneve 117 dhe 120 të KC-së ... afati 3-vjeçar për paraqitjen e padisë, me qëllim kërkimin e dëmit jashtëkontraktor, është parashkruar, duke shkaktuar humbjen e së drejtës së paditësit për të kërkuar rivendosjen e tij ... fatkeqësia që ka ndodhur në shëndetin e paditësit nuk përbën forcë madhore për mosparaqitjen e padisë në gjykatë dhe, për më tepër, të pezullimit të afatit të parashkrimit ... dispozitat ligjore njohin instrumente të tilla, si përfaqësimi apo kujdestaria, me anë të të cilave paditësi mund të ushtronte të drejtën e tij të pretenduar”*. Kurse Gjykata e Apelit Tiranë argumenton se: *“paditësi ka kërkuar edhe më parë të rivendoset në afat për kërkimin e një të drejte të tillë në rrugë gjyqësore, por Gjykata e Shkallës së Parë ka vendosur rrëzimin ... në këtë mënyrë jemi para gjësë së gjykuar”*.

15. Po ashtu, konstatohet se pretendimet e kërkuarit, në lidhje me interpretimin e gabuar të ligjit nga gjykatat e dy shkallëve të para, janë parashtruar edhe në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë. Kjo e fundit, duke mos pasqyruar në vendim asnjë pretendim të kërkuarit, ka vendosur mospranimin në dhomë këshillimi, me arsyetimin se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile.

16. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata rithekson qëndrimin tashmë të konsoliduar në jurisprudencën kushtetuese se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe i rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuarit për interpretimin e gabuar, nga ana e gjykatave më të ulëta, mbi momentin e fillimit të afatit 3-vjeçar të parashkrimit të padisë dhe gjënë e gjykuar, dhe për rrjedhojë, sipas tij, cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të mosgarantimit të aksesit në gjykatë, edhe pse përfshihen në parashikimet e nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, nuk rezulton të kenë marrë një përgjigje të arsyetuar nga Gjykata e Lartë.

17. Për pasojë, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë duhet të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me pretendimin e kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit, si një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

B. Në lidhje me pretendimin për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit

18. Sipas kërkuarit, Gjykata e Lartë nuk ka respektuar kërkesat e nenit 142/1 të Kushtetutës në lidhje me arsyetimin e vendimit gjyqësor. Edhe pse kërkuari parashtronte në rekurs shkelje të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor nga gjykatat më të ulëta, si dhe shkaqe të parashikuara nga neni 472 i KPC-së, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit pa u shprehur për shkaqet konkrete të mosprimit.

19. Gjykata ripohon se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 25, datë 10.6.2011 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në dhënien e vendimit. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjyqimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato

përmbledhin dhe finalizojnë, përfundimisht, qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimet nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 11, datë 2.4.2008 dhe nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit logjik. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion, të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 20, datë 13.4.2012 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjithsesi, Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referencat në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në këtë kuptim, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe, në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Neni 310/1 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se vendimi i gjykatës duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkuese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese, duke përcaktuar, në paragrafët e tjerë, elementet që duhet të përmenden në secilën prej këtyre pjesëve. Ndërsa për gjykimin në Gjykatën e Lartë, KPC-ja sanksionon se rekursi, ndër të tjera, duhet të përmbajë shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit, duke iu referuar normave ligjore mbi të cilat mbështetet (neni 475/ç), dhe se shqyrtimi i çështjes në kolegjet seleksionuese konsiston në një vlerësim të këtyre shkaqeve. Nëse rekursi bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që i lejon ligji, ai nuk pranohet dhe mospranimi i tij vendoset nga kolegji i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit (neni 480).

25. Nga parashikimet e normave të mësipërme procedurale, si dhe bazuar në veçoritë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe në praktikën e saj, Gjykata çmon se në funksion të realizimit të vëzhgimit publik të administrimit të drejtësisë, si dhe të koherencës së vendimit gjyqësor, në mënyrë që përfundimi i procesit të vlerësimit të gjykatës të jetë i mbështetur, përmbajtja e vendimit përbën premisën për përmbushjen e standardit të arsyetimit të vendimit, i cili në këtë drejtim duhet të plotësojë dhe të përmbajë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe ato të elaboruara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar (*shih vendimin nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimi i mospranimit, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, përmban, në pjesën hyrëse të tij, palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, disponimet e



gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të apelit dhe faktin se kundër vendimit të kësaj të fundit ka paraqitur rekurs kërkuesi, por nuk përmban shkaqet që ai ka parashtruar në rekurs. Ndërsa, në pjesën arsyetuese, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është mjaftuar me përfundimin se “*rekursi i paraqitur nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së*”, duke vendosur, në pjesën urdhëruese, mospranimin e tij.

27. Nga leximi në tërësi i vendimit, Gjykata vlerëson se, për shkakun e lartpërmendur, rrjedha logjike e përdorur në vendim nuk rezulton e qartë dhe e kuptueshme dhe se argumentet e pjesës hyrëse nuk janë të lidhura logjikisht me pjesën arsyetuese dhe atë urdhëruese. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pavarësisht se në vendim nuk paraqet cilat janë shkaqet e kundërshtimit të vendimit të apelit, ka arritur të bëjë një proces vlerësimi të tyre (shkaqeve) nëpërmjet të cilit ka arritur në konkluzionin e shprehur në dispozitiv. Gjykata vlerëson se pjesët e vendimit nuk formojnë një përmbajtje koherente brenda tij, çka bën që përmbajtja dhe arsyetimi i tij të mos kenë një harmoni të brendshme.

28. Gjykata, nisur dhe nga sa u argumentua më lart, çmon gjithashtu se, *prima facie*, mosparaqitja, në vendimin e Kolegjit Civil, e shkaqeve të parashtruara nga kërkuesi në rekurs, krijon dyshime edhe mbi cenimin e së drejtës së ankimit efektiv, si dhe të së drejtës për t’u dëgjuar, të pretenduara nga kërkuesi. Në këtë këndvështrim, pasqyrimi i shkaqeve të rekursit në pjesën hyrëse të vendimit të Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë, përbën një element të domosdoshëm dhe të rëndësishëm të tij, i cili nuk ka thjesht karakter formal në përmbajtjen e vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, mungesa e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs, në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, përbën një të metë, të pakapërcyeshme, të përmbajtjes së vendimit dhe të arsyetimit të gjykatës.

29. Në referim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se vendimi i mospranimit të rekursit, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, objekt shqyrtimi, nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit në këtë aspekt është i bazuar dhe duhet pranuar.

30. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit, për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë proceseve gjyqësore të zhvilluara në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, janë pjesërisht të bazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës¹.
 - Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2012-1527, datë 26.6.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
 - Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo, Vitore Tusha

¹ Gjyqtaret V. Tusha dhe A. Xhoxhaj votuan edhe për shfuqizimin e vendimit nr. 837, datë 23.6.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

MENDIM PAKICE DHE PARALEL

1. Në çështjen konkrete vlerësoj të shprehem me mendim pakice, pasi çmoj se për rivendosjen e të drejtave të pretenduara nga kërkuesi shumica duhet të kishte shfuqizuar edhe vendimin nr. 837, datë 23.6.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Kurse për sa i përket procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, vlerësoj të shprehem me mendim paralel, pasi çmoj se krahas mosrespektimit të standardit kushtetues të arsytimit të vendimit gjyqësor nga Kolegji Civil, të cilin shumica e ka vlerësuar si shkak për shfuqizimin e vendimit, ky i fundit duhet shfuqizuar si i papajtueshëm me Kushtetutën, edhe për shkakun se Gjykata e Lartë nuk ka korrigjuar dhe as plotësuar mangësitë e procesit të zhvilluar në Gjykatën e Apelit.

2. Kërkuesi ka pretenduar se proceset gjyqësore të zhvilluara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë i kanë kufizuar të drejtën e aksesit në gjykatë në dy aspekte: i) në aspektin kohor; dhe ii) në aspektin financiar. Në lidhje me pretendimin që lidhet me kufizimin e natyrës kohore, kërkuesi pretendon se interpretimi nga gjykatat i nenit 152 të KPC-së, duke konsideruar llogaritjen e afateve kohore të parashkrimit të veprimit civil të kërkimit të dëmshpërblimit nga ndodhja e aksidentit dhe jo nga ndërgjegjësimi i kërkuesit, i ka mohuar atij të drejtën për të gëzuar një dëmshpërblim të drejtë për dëmet e pariparueshme të shëndetit. Kufizimi kohor i parashikuar nga ligjvënësi për ushtrimin e së drejtës për dëmshpërblim, në kuptim të neneve 608, 625, 640, 641, 643 e vijues të Kodit Civil, duhet vlerësuar në raport me nenet 115, 117 dhe 120 të KC-së, që parashikojnë më shumë se një mundësi për përlllogaritjen e kohës së kufizimit të së drejtës themelore. Afati i parashkrimit 3-vjeçar, i parashikuar nga KPC-ja, në rastin konkret, llogaritet nga momenti që kërkuesi kishte mundësi të ndërgjegjësohej për dëmin shëndetësor e moral të shkaktuar nga aksidenti i vitit 2000. Gjatë shqyrtimit të çështjes gjykatat nuk kanë marrë në konsideratë as raportet mjekësore që konfirmojnë gjendjen shëndetësore dhe pamundësinë e tij për të kryer veprime juridike. Për sa u përket kufizimeve të natyrës financiare, kërkuesi argumenton se në kushtet e mosfunksionimit efektivist, në praktikë, të ndihmës ligjore, detyrimi për pagimin e taksës gjyqësore në shumën 1% të vlerës së pretenduar si dëmshpërblim, kufizon të drejtën e aksesit në gjykatë.

3. Në çështjen konkrete, rezulton se gjykatat e zakonshme kanë refuzuar të shqyrtojnë në themel pretendimet e kërkuesit në lidhje me shpërblimin e dëmit shëndetësor, me arsytimin se e drejta e paraqitjes së padisë është parashkruar. Në referim të kërkesave të nenit 115 të Kodit Civil, paditë për shpërblimin e dëmit jokontraktor parashkruhen brenda afatit prej 3 vjetësh. Neni 120 i KC-së parashikon se për kërkimin e shpërblimit të dëmit jokontraktor afati i parashkrimit të padisë fillon nga dita kur: a) i dëmtuari ka ditur; ose b) duhet të dinte për dëmin e pësuar dhe për personin që e ka shkaktuar. Po ashtu, neni 129 parashikon pezullimin e parashkrimit, duke listuar në shkaqet e pezullimit edhe forcën madhore (pika “ë”).

4. Si gjyqtare me mendim pakice, vlerësoj se arsytimit të gjykatave të zakonshme, mbi momentin e fillimit të afatit 3-vjeçar të parashkrimit, i mungon analiza e plotë e nenit 120 të KC-së, nga përmbajtja e të cilit evidentohen dukshëm dy momente për llogaritjen e afatit të parashkrimit: a) nga dita kur i dëmtuari *ka ditur* për dëmin e pësuar dhe personin që e ka shkaktuar dëmin; dhe b) nga dita kur *duhet të dinte* për dëmin e pësuar dhe personin që e ka shkaktuar dëmin. Nisur nga rregullat e interpretimit gramatikor, është e kuptueshme se norma parashikon dy mënyra të llogaritjes së afatit 3- vjeçar të parashkrimit, të cilat janë të ndryshme dhe përcaktohen në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, të shkallës së dëmit të shkaktuar, pasojave në shëndetin e të dëmtuarit. Në këtë vështrim, konkluzioni i gjykatave të zakonshme mbi parashkrimin e afatit të ngritjes së padisë pa analizuar mundësitë ligjore alternative, veçanërisht, të mundësisë së dytë nën dritën e rezultateve të raporteve më të fundit mjekësore, ndërhyrjeve kirurgjikale të njëpasnjëshme të kërkuesit në Itali, i ka mohuar kërkuesit të drejtën e ngritjes së padisë dhe të aksesit në gjykatë. Për rrjedhojë, interpretimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të Gjykatës së Apelit Tiranë është i



papajtueshëm me aspektet e së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

5. Në respekt të parimit të subsidiaritetit, të ekonomisë gjyqësore dhe të administrimit sa më efektiv dhe praktik të drejtësisë, po ashtu, bazuar në kufijtë e ndryshëm ligjorë të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë me atë të Apelit, si dhe nisur nga natyra e rrethanave të çështjes konkrete, mendoj se shumica duhej të shfuqizonte edhe vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë. Në referim të nenit 465 të Kodit të Procedurës Civile, në shqyrtimin në apel mbahen parasysh, për aq sa janë të zbatueshme, dispozitat mbi procedurën e gjykimit në shkallë të parë. Me kërkesë të palëve ose edhe kryesisht, gjykata e apelit përsërit tërësisht ose pjesërisht hetimin gjyqësor. Në shqyrtimin gjyqësor mund të lexohen aktet e gjykimit në shkallë të parë dhe, po ashtu, gjykata ka të drejtë të marrë edhe prova të reja. Nisur nga këto kompetenca të Gjykatës së Apelit, vlerësoj se kjo e fundit e shqyrton çështjen duke iu referuar krahas ligjit edhe fakteve konkrete dhe provave.

6. Në vështrim të sa më sipër e konsideroj të gabuar qëndrimin e shumicës se pretendimet e kërkuarit, mbi interpretimin e gabuar të ligjit në lidhje me fillimin e afateve të parashkrimit, kanë të bëjnë me vlerësimin e provave, mënyrën e interpretimit të fakteve dhe të zbatimit të ligjit nga ana e gjykatave të zakonshme, duke parashikuar, për rrjedhojë, vetëm detyrimin e Gjykatës së Lartë për t'i dhënë përgjigje këtyre pretendimeve, referuar rolit të asaj gjykate në kontrollin e respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Në këtë kuptim, në lidhje me gjykimin në Gjykatën e Lartë, shpreh qëndrimin paralel, se krahas mosrespektimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor (qëndrimi i shumicës), ekziston edhe shkaku i mësipërm, për të cilin vendimi i Kolegjit Civil duhet të shfuqizohet si i papajtueshëm me Kushtetutën, shkak të cilin shumica nuk e ka trajtuar në vendimmarrje.

7. Nisur nga qëndrimi tashmë i konsoliduar i jurisprudencës kushtetuese se gjykimi kushtetues synon të vlerësojë nëse procesi, si i tërë, ka qenë i rregullt, duke u ndalur në ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të palëve në proces dhe po ashtu, bazuar në faktin se përbën cenim të parimit për një proces të rregullt ligjor rasti kur gjykata e shkallës më të lartë, duke u bazuar në kompetencat që i jep Kodi i Procedurës, nuk ka plotësuar apo nuk ka korrigjuar mangësitë dhe gabimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 5, datë 25.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*), vlerësoj se shkelja e së drejtës së kërkuarit për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të mosrespektimit të aksesit si rezultat i interpretimit të gabuar të ligjit nga gjykatat e zakonshme, nuk është plotësuar ose korrigjuar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë. Në këto kushte, çmoj se rivendosja e të drejtave të cenuara të kërkuarit bëhet e mundur përmes kthimit të çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Anëtare: Vitore Tusha

VENDIM
Nr. 53, datë 9.12.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“

me sekretare Elta Milori, në datën 11.7.2013 mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen nr.20 Akti, që i përket:

KËRKUES: Miftar Ahmetaj, përfaqësuar nga avokati Rustem Gjata, me akt përfaqësimi.

Mediha Blaca, përfaqësuar nga avokati Fatmir Braka, me akt përfaqësimi.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ibrahim Bilali, përfaqësuar nga avokate Zana Hasko, me akt përfaqësimi. Llambi Avale, përfaqësuar nga avokate Irena Reso, me deklaram.

Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr. 00-2011-2343 (542), datë 24.11.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 1534, datë 21.3.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 00-2011-2343 (542), datë 24.11.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 28, 45 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Altina Xhoxhaj; përfaqësuesit e kërkuësve që kërkuan pranimin e kërkesës; përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, që kërkuan rrëzimin e kërkesës dhe, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 833, datë 14.11.1994, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Tiranë, ka njohur pronësinë e shtetasit Qazim Bllaca mbi një sipërfaqe trualli prej 1110 m², duke i kthyer fizikisht 600 m², si truall i lirë, dhe duke e kompensuar për sipërfaqen prej 510 m².

2. Me vendimin nr. 706, datë 30.9.1996, KKKP-ja Tiranë ka njohur pronësinë e shtetasit Ibrahim Bilali mbi një sipërfaqe trualli prej 1080 m², duke i kthyer fizikisht 800 m², si truall i lirë, dhe duke e kompensuar për sipërfaqen prej 280 m². Një pjesë të kësaj sipërfaqeje trualli, shtetasi Ibrahim Bilali ia ka shitur shtetasit Llambi Avale.

3. Me kontratën e shitjes nr. 3087 rep., nr. 586 kol, datë 25.11.1996, kërkuesi Miftar Ahmetaj ka blerë nga shtetasi Qazim Bllaca sipërfaqen prej 600 m², mbi të cilën ka ndërtuar një godinë 9-katëshe.



4. Me pretendimin se midis pronave të mësipërme ka mbivendosje, shtetasit Qazim Bllaca dhe Miftar Ahmetaj, i janë drejtuar gjykatës me padi për anulimin e vendimit nr. 706, datë 30.6.1996 të KKKP-së Tiranë, që ka disponuar në favor të shtetasit Ibrahim Bilali, dhe detyrimin për njohjen pronarë e kthimin e sendit.

5. Në proces ka ndërhyrë me padi Llambi Avale, në cilësinë e ndërhyrësit kryesor, i cili ka kërkuar anulimin e vendimit nr. 833, datë 14.11.1994 të KKKP-së, të dhënë në favor të paditësit Qazim Bllaca.

6. Me vendimin nr. 1534, datë 21.3.2005, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: *“Rrëzimin e padisë së paditësve Qazim Bllaca e Miftar Ahmetaj, si të pambështetur në ligj e në prova. Pranimin e ndërhyrjes kryesore. Anulimin e vendimit nr. 833, datë 14.11.1994 të KKKP-së ish pronarëve, dhënë në favor të paditësit Qazim Bllaca. Detyrimin e paditësve Qazim Bllaca e Miftar Ahmetaj ta njohin ndërhyrësin kryesor, Llambi Avale, pronar për sipërfaqen e truallit prej 600 m². Fshirjen e regjistrimit në ZRPP të kësaj prone, në favor të paditësit Qazim Bllaca, të bërë mbi bazën e këtij vendimi.”*

7. Me vendimin nr. 813, datë 15.7.2005, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

8. Me vendimin nr. 880, datë 4.7.2006, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur: *“Prishjen e vendimit nr. 813, datë 15.7.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim me tjetër trup gjykues.”*

9. Me vendimin nr. 1529, datë 7.12.2007, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. 1534, datë 21.3.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në këtë mënyrë: Pranimin e padisë. Anulimin e vendimit nr. 760, datë 30.9.1996 të KKKP-së ish-pronarëve, Tiranë. Detyrimin e të paditurit Ibrahim Bilali dhe ndërhyrësit kryesor Llambi Avale të njohin pronarë paditësit, trashëgimtarët ligjorë të Qazim Bllacës, e Miftar Ahmetaj, mbi truallin objekt gjykimi, kthyer me vendimin nr. 833, datë 14.11.1994 të KKKP-së Tiranë. Rrëzimin e kërkesëpadisë së ndërhyrësit kryesor Llambi Avale.”*

10. Me vendimin nr. 00-2011-2343 (542), datë 24.11.2011, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur: *“Prishjen e vendimit nr. 1529, datë 7.12.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 1534, datë 21.3.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.*

II

11. *Kërkesit Miftar Ahmetaj dhe Mediha Bllaca* (trashëgimtare e paditësit Qazim Bllaca, për të cilën është bërë dhe kalimi procedural në procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë) i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, për këto shkaqe:

11.1 Gjykata e Lartë ka kapërcyer kompetencat ligjore, duke dalë tej funksionit të saj rishikues. Krejt ndryshe nga provat e faktet që ka pranuar gjykata e apelit në rigjykimin e çështjes, Kolegji Civil ka konkluduar se pretendimi i kërkuësve për vendosjen e pronës nuk është provuar gjatë seancës gjyqësore. Duke prishur vendimin e gjykatës së apelit me argumentin se prona e kthyer nuk rezulton të ndodhet në vendin ku është kthyer, Gjykata e Lartë ka bërë vlerësim të provave, madje në të kundërtën e vlerësimit që u ka bërë këtyre provave gjykata e apelit, megjithëse nuk e kishte një kompetencë të tillë.

11.2 Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e paanësisë në gjykim, e kuptuar si barazi e armëve, i cili kërkon që palët të trajtohen në mënyrë të tillë që të kenë të njëjtat pozita procedurale gjatë rrjedhës së gjykimit dhe të njëjtat mundësi e të drejta për të paraqitur çështjen e tyre. Duke bërë vlerësime për provat, në kushtet kur kërkesit nuk kishin të drejtë të diskutonin për to në Gjykatën e Lartë, ata janë vënë në pozitë të diferencuar në raport me palën kundërshtare.

11.3 Gjykata e Lartë nuk ka respektuar detyrimin për arsyetimin e vendimit gjyqësor. Ajo nuk ka arsyetuar se për cilat shkaqe nuk ka pranuar konkluzionet dhe interpretimet juridike që ka bërë gjykata e apelit në rigjykimin e çështjes.

12. **Subjekti i interesuar Ibrahim Bilali**, në parashtrimet e tij drejtuar Gjykatës Kushtetuese, ka paraqitur këto prapësime:

12.1 Gjykata e Lartë ka vepruar si gjykatë e caktuar me ligj dhe brenda kompetencave të përcaktuara në nenet 472 dhe 485 të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Kolegji Civil nuk ka rivlerësuar në mënyrë të ndryshme provat e administruara në gjykim, por ka ushtruar kompetencën e tij duke kontrolluar ligjshmërinë e vendimeve të gjykatave më të ulëta, vetëm duke u bazuar në provat dhe rrethanat e administruara në gjykimet e zhvilluara në gjykatat më të ulëta, duke pranuar, në përfundim të gjykimit, si të drejta dhe në përputhje me ligjin, vlerësimin dhe konkluzionet e nxjerra nga gjykata e shkallës së parë.

12.2 Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim, kërkuesit nuk paraqesin asnjë argument mbi të cilin e mbështesin atë, në përputhje me standardet e përcaktuara nga Gjykata Kushtetuese.

12.3 Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të barazisë së palëve dhe të drejtës së mbrojtjes, kërkuesit nuk i referohen asnjë rrethane apo fakti të ndodhur gjatë procesit gjyqësor, por ai lidhet me pamundësinë për të kundërshtuar faktet e reja që, sipas kërkuesve, janë pranuar në Gjykatën e Lartë. Edhe lidhur me këtë pretendim parashtror se Gjykata e Lartë nuk ka marrë dhe as vlerësuar në mënyrë të ndryshme fakte të provuara nga gjykatat e faktit dhe, në këto kushte, nuk mund të diskutohet për heqje të mundësisë së ndonjë pale për të debatuar, pasi provat kanë qenë më parë objekt debati në gjykatat e faktit.

12.4 Pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke vepruar në bazë të kompetencave të tij, i ka dhënë përgjigje pretendimeve të palëve, të vlerësuara sipas bindjes së tij, e të shprehura në vendimin përfundimtar. Vendimi plotëson kërkesat e nenit 310 të KPC-së dhe në të janë analizuar dhe arsyetuar gjerësisht faktet dhe arsyet që e çuan Gjykatën e Lartë në marrjen e këtij vendimi.

12.5 Pretendimet e tjera të kërkuesve janë çështje që kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e ligjit dhe nuk i përkasin juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese. Për më tepër, ato janë analizuar, vlerësuar dhe debatuar më parë në gjykimet e zakonshme dhe u është dhënë përgjigje e arsyetuar nga ato gjykata.

13. **Subjekti i interesuar Llambi Avale**, në parashtrimet e tij drejtuar Gjykatës Kushtetuese, ka paraqitur këto prapësime:

13.1 Gjykata e Lartë ka vepruar brenda kompetencave të përcaktuara në nenet 472 dhe 485 të KPC-së, si gjykatë e caktuar me ligj, duke respektuar standardet e një procesi të rregullt ligjor, përfundimi i të cilit i ka dhënë zgjidhje një çështjeje të gjykuar e rigjykuar disa herë. Neni 472 i KPC-së i jep të drejtë Kolegjit Civil të shqyrtojë e analizojë provat dhe rrethanat e pranuar nga gjykatat më të ulëta, pra edhe të gjykatës së apelit, mbi të cilat ai analizon e vlerëson ligjshmërinë e vendimeve të marra prej tyre, si dhe të vendosë sipas bindjes së tij. Neni 485/b i KPC-së i jep të drejtë Kolegjit Civil të prishë vendimin e gjykatës së apelit dhe të lërë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, qëndrim ky i vlerësuar kushtetues nga Gjykata Kushtetuese. Kolegji Civil nuk ka nxjerrë konkluzione për provat dhe as ka bërë rivlerësim të tyre në të kundërt me atë të gjykatave më të ulëta, pasi lënia në fuqi e vendimit të shkallës së parë provon se ai ka pranuar të ligjshme konkluzionet e asaj gjykate.

13.2 Pretendimi për cenimin e parimit të barazisë së palëve në gjykim është i pabazuar, pasi gjykimi në Gjykatën e Lartë është zhvilluar në prani në palëve, të cilat, pa asnjë kufizim, kanë parashtruar pretendimet e tyre, madje duke dhënë edhe shpjegime për pyetjet e bëra nga trupi gjykues.



13.3 Pretendimi për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar, pasi vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë plotëson kërkesat e nenit 310 të KPC-së, si dhe standardet e përcaktuara nga Gjykata Kushtetuese.

III

Lidhur me kërkesën për pezullim

14. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese mori në shqyrtim, përpara seancës plenare, kërkesën për pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 1534, datë 21.3.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 00-2011-2343 (542), datë 24.11.2011, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Në kuptim të nenit 45, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me vendimin e datës 29.5.2013, Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullim, për arsye se nuk ndodhej para kushteve të parashikuara në këtë dispozitë.

IV

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Lidhur me pretendimin për cenimin e standardit kushtetues të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj

15. Kërkesit pretendojnë se Gjykata e Lartë, në kundërshtim me funksionin e saj si gjykatë e ligjit, ka vlerësuar në mënyrë të ndryshme provat dhe rrethanat e çështjes, duke arritur në konkluzione të ndryshme nga ato të gjykatës së apelit gjatë rigjykimit të çështjes. Sipas tyre, krejt ndryshe nga provat dhe faktet e pranuar nga gjykata e apelit, Kolegji Civil, mbi të njëjtat prova, ka konkluduar se pretendimi i kërkuar për vendndodhjen e pronës nuk është provuar gjatë seancës gjyqësore dhe ka prishur vendimin e gjykatës së apelit me argumentin se prona e kthyer nuk rezultoi të ndodhet në atë vend ku është kthyer.

16. Gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, i sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Gjykata ka theksuar se termi “gjykatë” karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente, kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t’i jetë dhënë asaj prej ligjit (*shih vendimet nr. 31, datë 1.12.2005; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 22, datë 22.7.2009; nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në kuptim të funksionit rishikues të Gjykatës së Lartë, i sanksionuar në nenin 141 të Kushtetutës, Gjykata ka vlerësuar se kompetenca e saj për shqyrtimin e çështjeve nuk bazohet mbi të njëjtat dispozita procedurale të cilave u referohen gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit. Në të drejtën procedurale civile, kufijtë brenda të cilëve Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë shqyrton çështjet mbi rekursin e ushtruar janë parashikuar në nenet 472 dhe 485 të KPC-së. Sipas nenit 472 të KPC-së, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka në kompetencë të shqyrtojë problemet që kanë të bëjnë me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural, kurse neni 485 i KPC-së i ka dhënë të drejtë Kolegjit Civil apo Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që, ndër të tjera, të vendosin prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe të lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe të ndryshojnë njëkohësisht vendimet e të dy gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 31, datë 1.12.2005; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, kontrolli që ushtron Gjykata e Lartë duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuar, 8064

pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Siç ka theksuar edhe më parë Gjykata, vlerësimi që kryen Gjykata e Lartë, në kuptim të neneve 472 dhe 485 të KPC-së, lidhet me çështjet që kanë të bëjnë me mosrespektimin e ligjit ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural, ndaj provave të administruara në gjykimin e faktit dhe që i janë nënshtruar debatit gjyqësor. Individualizimi i provave, të cilat përbëjnë burimin e bindjes së gjyqtarit, dhe administrimi i tyre janë çështje që i përkasin gjykimit të faktit dhe, si të tilla, ndajnë juridiksionin e atyre gjykatave nga ai i Gjykatës së Lartë si gjykatë e ligjit. Gjykata e Lartë jo vetëm nuk ka kompetencën të administrojë prova të reja, por as nuk mund të anashkalojë ekzistencën e fakteve dhe rrethanave që janë vërtetuar në gjykimin e faktit, t'i ndryshojë ato, apo të arrijë në konkluzione për faktet e çështjes që bien në kundërshtim me përfundimet e gjykatave më të ulëta (*shih vendimin nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Bazuar në konsideratat e mësipërme dhe në rrethanat e çështjes konkrete në shqyrtim, Gjykata vëren se në arsyetimin e vendimit të gjykatës së apelit (vendimi nr. 1529, datë 7.12.2007), dy kanë qenë argumentet kryesore ku ajo është mbështetur për të arritur në përfundimin se vendimi i KKKP-së nr. 706, datë 30.9.1996, i dhënë në favor të subjektit të interesuar Ibrahim Bilali, duhet të anulohet: së pari, se komisioni ka disponuar dy herë për të njëjtën pronë, edhe pse kishte disponuar më parë për këtë pasuri në favor të shtetasit Qazim Bllaca, dhe se ai është bazuar në një vendim gjyqësor vërtetim fakti; së dyti, se akti i ekspertimit ka përcaktuar se toka truell objekt gjykimi përputhet me pronën e Qazim Bllacës dhe përfundimet e ekspertëve rrëzojnë pretendimet e palës së paditur (Ibrahim Bilali dhe Llambi Avale).

20. Në ndryshim nga sa ka konkluduar gjykata e apelit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se “... Në çështjen në shqyrtim gjykata ka bazuar vendimin e saj në një akt ekspertimi të marrë në përputhje me nenin 224/a të KPC-së. Gjykata, referuar konstatimeve të bëra nga ekspertët K.A. e E.N., por në të kundërtën me sa paraqitet në aktin e ekspertimit për sa i përket pronave të secilës palë, në lidhje me vendndodhjen e tyre, ka pranuar faktin se truallit objekt gjykimi përputhet me pronën e paditësit Qazim Bllaca. Referimi vetëm në atë çka ka konstatuar eksperti, dhe më tepër ndryshe nga këto konstatime, madje pa parashtruar as arsyetimin e saj, pa analizuar në vendim provat e tjera shpresore të administruara, përbën qëndrim të gabuar të gjykatës, sepse ajo ngatërron rolin e saj me atë të ekspertëve... Përfundimi i gjykatës së apelit në lidhje me vendndodhjen e truallit objekt gjykimi është në kundërshtim me aktin e ekspertimit, pasi në këtë akt (edhe në të gjitha aktet e ekspertimit të kryera gjatë gjithë gjykimeve), është konkluduar se parcela nr. 664 prej 1110,25 m², veçohet nga grumbulli i tokave shtetërore të regjistruara në regjistrat e hipotekave me nr. 671/462, 672/463 e 673/464... Gjithashtu, në kundërshtim me sa ka pranuar gjykata e apelit, ekspertët e thirrur në seancë gjyqësore datë 10.07.2007, në këtë gjykatë, kanë deklaruar se: “Familja Bllaca e ka pronën aty ku është ngjyra jeshile sipas dokumentacionit, ndërsa tek ngjyra e verdhë është sipërfaqja ku e ka kthyer KKKP-ja... Referuar vendimit të KKKP-së, prona e paditësve ndodhet tek sipërfaqja me ngjyrë të verdhë, ndërsa referuar akteve të vjetra kjo pronë duhet të ndodhet tek sipërfaqja me ngjyrë jeshile, kjo sipas dokumenteve të origjinës”...”. Në përfundim të arsyetimit të saj, duke arritur në përfundimin se mes pronave nuk ka mbivendosje në një kohë që gjykata e apelit, pas vlerësimit të aktit të ekspertimit kishte konkluduar të kundërtën, Gjykata e Lartë ka prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe ka lënë në fuqi atë të shkallës së parë.

21. Nga arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Lartë, Gjykata vëren se ai është bazuar mbi vlerësimin dhe shqyrtimin e një akti ekspertimi të administruar në gjykatat e faktit. Ndërsa gjykata e apelit, bazuar në kuadrin ligjor që rregullon kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve, si dhe ligjin për urbanistikën, ka vlerësuar se vendimi i KKKP-së, i dhënë në favor të subjektit të interesuar, është absolutisht i pavlefshëm, pasi komisioni nuk kishte kompetencë të shprehej për këtë pasuri, në kushtet kur kishte disponuar më parë për të, si edhe se në lidhje me subjektin e interesuar nuk ka asnjë të dhënë për ndonjë titull pronësie në provat e paraqitura në gjykim, Gjykata e Lartë i ka anashkaluar të gjitha këto përfundime të gjykatës së apelit, edhe pse ato kanë qenë argumentet



kryesore të atij vendimi. Gjykata e Lartë, duke e bazuar të gjithë arsyetimin e vendimit të saj vetëm në një akt ekspertimi, ka dalë tej funksionit të saj si gjykatë ligji. Edhe pse Gjykata e Lartë, për arritjen në përfundimet e saj, e interpreton dhe e zbaton ligjin mbi provat e administruara në gjykimin e faktit, arsyetimi i saj nuk mund të mbështetet vetëm mbi analizën e provave të shqyrtuara dhe të vlerësuara mjaftueshëm nga gjyqtari i faktit, pa analizuar dhe pa dhënë asnjë argument të natyrës ligjore, për prishjen e vendimeve të gjykatave më të ulëta.

22. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe zgjidh vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimet nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 27, datë 24.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese*). Por, në rastin konkret, Kolegji Civil ka nxjerrë konkluzione për provat, të ndryshme nga ato të gjykatës së apelit, megjithëse nuk e ka një kompetencë të tillë. Ai e ka zgjidhur çështjen duke u ndalur vetëm në analizën dhe vlerësimin e aktit të ekspertimit, përfundimet e të cilit janë i vetmi argument për prishjen e vendimit të gjykatës së apelit, dhe duke anashkuar çdo vlerësim të mënyrës së zbatimit dhe respektimit të ligjit nga ajo gjykatë. Në këtë mënyrë, arritja e një përfundimi nga ana e Gjykatës së Lartë, bazuar tërësisht mbi analizën dhe rivlerësimin e një prove siç është akti i ekspertimit, i vlerësuar ndryshe nga gjykata e apelit, pa pasur asnjë referencë apo argument ligjor, e ka deformuar këtë proces duke e shndërruar atë në një proces gjykimi të zakonshëm.

23. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se ky qëndrim i mbajtur nga Gjykata e Lartë përbën tejkalim të kompetencave të saj ligjore dhe, pra, cenim të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

B. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit

24. Kërkesit pretendojnë se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka shkelur parimin e paanësisë në gjykim dhe të barazisë së armëve, për arsye se duke bërë vlerësime për provat, në kushtet kur kërkesit nuk kishin të drejtë të diskutonin për to në Gjykatën e Lartë, i ka vënë ata në pozitë të disfavorshme krahasuar me palën tjetër.

25. Gjykata ka theksuar se e drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur e të caktuar me ligj, kërkon edhe që gjykata t'i krijojë secilës palë të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjake, në raport me palën kundërshtare. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njëres palë do të prevalonin mbi argumentet e palës tjetër dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues, për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 23, datë 8.6.2007; nr. 34, datë 25.7.2011; nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Bazuar në standardet e mësipërme dhe rrethanat e çështjes konkrete, në rastin konkret nuk rezulton që kërkesit të jenë vënë në situatë të disfavorshme krahasuar me palën tjetër në gjykim. Ata janë njoftuar për rekursin e palës kundërshtare, janë njohur me të, kanë marrë pjesë në seancën gjyqësore në Gjykatën e Lartë, ku kanë pasur mundësi të parashtrajnë të gjitha kundërshtimet e tyre lidhur me pretendimet e paraqitura nga pala tjetër. Po ashtu, vlerësimet e Gjykatës së Lartë janë bazuar mbi prova të administruara dhe debatuar në një gjykim të barabartë dhe në zbatim të parimit të kontradiktoritetit.

27. Si përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve për cenimin, nga ana e Gjykatës së Lartë, të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit nuk është i bazuar.²

C. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të arsytimit të vendimit gjyqësor

28. Kërkuesit pretendojnë se vendimi i Kolegjit Civil nuk përmbush standardin kushtetues për arsyetimin e tij. Sipas kërkuesve, Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar se për cilat shkaqe nuk ka pranuar konkluzionet dhe interpretimet juridike që ka bërë gjykata e apelit në rigjykimin e çështjes.

29. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Përfundimet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Vendimet gjyqësore duhet të mbështeten vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajnë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Pra, gjyqtari duhet të shpjegojë arsyet e vendimeve të tij, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të ndryshme të palëve (*shih vendimin nr. 11, datë 2.4.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, pasi detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe masa e arsytimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 25, datë 10.6.2011; nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se vlerësimi që ajo bën ndalet në verifikimin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit, çka mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në vlerësimin e Gjykatës, nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave (*shih vendimet nr. 34 datë 3.10.2007; nr. 34, datë 25.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se tejkalimi nga ana e Gjykatës së Lartë i kompetencave të saj, duke e mbështetur vendimin vetëm mbi analizë provash dhe pa dhënë asnjë argument të natyrës ligjore për këtë qëndrim, cenon edhe standardin e arsytimit të atij vendimi. Në kushtet kur funksioni i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e

² Gjyqtari S. Berberi ka vlerësuar se edhe ky pretendim i kërkuesit është i bazuar. Sipas tij, përderisa Gjykata arriti në përfundimin se është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, për rrjedhojë, duhet pranuar se është cenuar dhe parimi i barazisë së armëve dhe i kontradiktoritetit.



ligjit, konsiston në vlerësimin e mënyrës së zbatimit dhe interpretimit të ligjit nga gjykatat e faktit, edhe arsyetimi i vendimeve të saj duhet të bazohet në argumente që i referohen moszbatimit apo keqinterpretimit të ligjit material apo procedural nga ato gjykata. Në rastin konkret, mungesa e këtyre argumenteve ligjore përbën cenim edhe të standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit 00-2011-2343 (542), datë 24.11.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Vendosur më datë 25.9.2013

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 11701, datë 22.11.2013 vendosi shpalljen e zhdukjes së shtetasit Eduart Belegu.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 24 lekë